



Sistemet e suvave dhe fasadave
Fletë teknike

01.07.2012
P 121

ROTBAND Suva me bazë gipsi, me aftësi të lartë lidhëse

Përshkrimi i produktit

ROTBAND është një suva gipsi, me aftësi lidhëse me materiale speciale ndihmëse lehtësuese. Për shkak të aftësive lidhëse, kjo suva është e përshtatshme për tavanet e betonit dhe sipërfaqet e murit si dhe për suvatimin e elementëve të parafabrikuar betoni dhe mbi të gjitha sipërfaqet e zakonshme të suvatuara. Për të gjitha ambientet me lagështi

normale të ajrit, përfshirë ambientet e banimit me lagështi si kuzhina dhe tualeti.

Karakteristikat

Material i thatë, i përzier, i parapërgatitur
Produktiv
Sipërfaqe e strukturueshme ose e lëmueshme
I butë gjatë përpunimit

Suva një-shtresore
Kohë e gjatë përpunimi
Fortësohet njëtrajtësisht
E fortë nga shtypja, gërvishtja dhe shtytja
Difuzuese e avujve
Përpunohet me dorë
Koha e përpunimi rreth 1,5 orë

Zbatimi

Paratrajtimi

Astarët e suvasë dhe paratrajtuesit: Sipërfaqja për tu suvatar pastrohet nga pluhuri dhe mbeturinat, disnivelet e mëdha eliminohen.

Beton dhe beton i lehtë: Largohej cipa e hollë e solucioneve për ndarjen e betonit nga betoforma si dhe eventualisht cipat e krijuar sinter. Për betone me aftësi jo të mjaftueshme thithëse dhe betone të kompresuar, sipërfaqja lyhet me Knauf BETOKONTAKT dhe lihet të thatet.

Tavanet e sheshta, elementët e parafabrikuar betoni: Gjatë suvatimit të tavanëve të sheshta prej betonarme ose prej elementëve të parafabrikuar betoni, sipërfaqja duhet të paratrajtohet me Knauf BETOKONTAKT. Suvatet e elementëve konstruktivë fqinjë ndahen me shiritin Knauf Trenn-Fix 65 ose ose pas suvatimit, suvaja prehet vertikalisht nga sipërfaqja e murit.

Mure tulle e të gjithë llojeve: Për sipërfaqe me aftësi të lartë thithëse, paratrajtimi me Knauf

AUFBRENNSPERRE / GRUNDIERMITTEL.

Asfalt i nxehtë: Në rast se pas suvatimit parashikohet të shtrohet asfalt i nxehtë, duhet të kihet kujdes për eliminimin e tensioneve si pasojë e nxehtësisë si dhe për një ajrim të mjaftueshëm.

Përpunimi

Një thes (30 kg) ROTBAND shpërndahet në rreth 20 l ujë të pastër dhe përzihet pa shtesa të tjera me mikser deri në krijimin e një masë homogjene pa toptha. Brenda 20 minutave pas përzierjes, masa tërhiqet dhe nivelohet. Pas një njomje të lehtë, sipërfaqja filcohet dhe lëmohet. Për një tharje më të shpejtë, kërkohet një ajrim i mjaftueshëm. Koha e përpunimit: nga koha e përzierjes rreth 1 deri 1,5 orë, në varësi të sipërfaqes që do të suvatohet. Enët dhe veglat e punës të pa pastërta zvogëlojnë kohën e përpunimit. Trashësia mesatare e suvasësë 10 mm, minimale 5 mm. Për trashësi më të mëdha suvaje në mur duhet të suvatohet me dy shtresa. Shtresa e parë tërhiqet ashpër me mastar

ose me stuko Flächenspachtel. Pas tharjes së plotë të shtresës së parë, sipërfaqja lyhet me AUFBRENNSPERRE (hollimi 1:2). Vetëm pas tharjes së plotë të astarit mund të vazhdohet me hedhjen e shtresës së dytë. Tavanet suvatohen përgjithësisht vetëm me një shtresë. Për cilësinë e sipërfaqes K1-K3 suvaja vetëm tërhiqet dhe për K2-K3 suvaja lëmohet. Për cilësinë K4 për një sipërfaqe perfekte, lëmimi kryhet sëbashku me stukon Knauf MULTI-FINISH apo READYGIPS.

Vërejtje të veçanta

Paratrajtimi për sipërfaqet që do të vishen me pllaka: Trashësia minimale e suvasë një-shtresore 10 mm. Lagështia e suvasë maks. 1%. Sipërfaqja e suvasë drejtohet dhe tërhiqet (nuk filcohet dhe/ose lëmohet) dhe lihet e ashpër. Për kollë pllake me shtresë të hollë, paratrajtimi me astar kryhet me Knauf Tiefengrund deri te bashkimi i tavanit.

Zbatimi

Ngjitja e pllakave të kryhet me kollë me përmbajtje çimento (Knauf Fliessenkleber N) ose kollë me përmbajtje rezine sintetike. Stukimi i fugave me bojak kryhet vetëm pasi kolla të jetë tharë plotësisht. Në zonat në kontakt me ujin me sprucim, këshillohet një paratrajtim me Knauf Flächendicht. Ngjitja me kollën Knauf Flexkleber ose Knauf Fliessenkleber me Knauf Elast. Paratrajtimi për shtresat dhe veshjet mbi suva:

Suvaja duhet të jetë e thatë, e qëndrueshme dhe pa pluhur. Paratrajtimi zgjidhet në varësi të sipërfaqes së punueshme. Të përshtatshme janë: Astar dispersion p.sh. GRUNDOL Tiefengrund ELF, ngjitës për letra murale deri te parangjitësit. Mbrojtja nga zjarri: Trashësia e suvasë në sipërfaqet e betonit duhet të jetë të paktën 10 mm. **Makineritë / pajisjet / veglat e punës** Enë gome për përzierje, mikser, mastar

prerës, mastar shtrirës, sfungjer për filcim dhe shpatull patinimi.

Paketimi/magazinimi

Në thasë 30,0 kg mbi paleta druri në ambiente të thata, kohë magazinimi rreth 3 muaj.

Të dhënat teknike

(DIN V 18550)	
Dendësia e masës:	rreth 730 kg/m ³
Fortësia e shtypjes së kokrizës	9,0 N/mm ²
Fortësia në përkulje:	1,5 N/mm ²
Fortësia në shtypje:	> 3,0 N/mm ²
Pesha për njësi volumi:	rreth 950 kg/m ³
Vlera e rezistencës së difuzionit te avujve μ:	5
Aftësia e transmetimit të nxehtësisë	0,25 W/mK

Sasia e nevojshme e materialit

	Kokrriza	Trashësia suvasë mm	Harxhimi kg/m ²	Produktiviteti m ² /thes
ROTBAND	1,2 mm	5,0	4,0	7,5
ROTBAND	1,2 mm	10,0	8,0	3,8

Tekst për preventiv

Poz.	Përshkrimi	Sasia	Çmimi/njësi	Vlera
.....	6.12.20 Suva me aftësi lidhëse - Knauf ROTBAND Suva me aftësi lidhëse me lidhje minerale, për tu punuar me dorë, vendoset sipas normës DIN 1053 në trashësi mesatare 10 mm, tërhiqet dhe nivelohet, pas fortësimit lëmohe/filzohet. Sipërfaqja: Cilësia K2 - shtrihet/lëmohe/filzohetm ²EUREUR
* Fshini të panevojshmet				

Knauf Direkt
Shërbimi telefonik:
▶ Tel.: ++35542248714
▶ Fax: ++35542257761
▶ www.knauf.al
▶ E-mail: info@knauf.com.al

Fabrika: Knauf Radika AD bul. 8 Shtetpuri bb. MK-1250 Debar
Knauf Tirana sh.p.k Rr. "Jeronim De Rada", Nd. 1, H. 25, Ap. 4
1017 Tiranë, Albania



Ruhet e drejta e ndryshimeve teknike. Vlen botimi përkatës aktual.
Të dhënat mbi konsumin, sasinë dhe mënyrën e punës janë të testuara si dhe të zbatuara në praktikë.
Për të gjitha ndryshimet, ribotimet, kopjimet e plota dhe te pjesëshme, kërkohet miratimi i plotë i firmës Knauf.